



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT PËR VITIN
2020**

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë

Adresa: Sheshi "Zahir Pajaziti", 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (Ministria), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Obligimet e papaguara të raportuara në Raportin Vjetor Financiar ishin prezantuar në vlerë 63,355,509€, ndërsa do të duhej të prezantoheshin në vlerë 61,750,945€, pra ishin mbivlerësuar për 1,604,564€.
- C1 Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK nuk ishin regjistruar shtatë (7) pagesa nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë totale prej 1,854,032€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B2 Ministria në dhjetë raste në vlerë prej 1,421,558€ kishte tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh për pagesë. Këto obligime kanë të bëjë me kategorinë e investimeve kapitale dhe vonesat ishin prej 6 deri 124 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Gjatë vitit 2020 në Ministri ka pasur një numër të konsiderueshëm të ndryshimeve strukturore dhe të menaxhmentit. Deri më 19.02.2020, pesë ministri të ndryshme kishin funksionuar të ndara nga njëra tjetra.
Në bazë të rregullores (QRK) -nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive neni 14 'Ministritë' paragrafi 1.7, themelohet (Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS). Në këtë ministri ishin fuzionuar: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe një pjesë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo rregullore ishte miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/03 e datës 19.02.2020.

Në bazë të rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive përkatësisht, neni 14 Ministritë paragrafi 1.9 themelohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA). Kjo rregullore ishte miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/03 të datës 06.06.2020. Ku ishin larguar ish Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjatë këtyre ristrukturimeve ishin ndryshuar tre Sekretar të Përgjithshëm dhe zyrtarë tjerë të rëndësishëm me përgjegjësi dhe detyra të ndryshme. Po ashtu, në këtë ministri kishte ndryshime strukturore edhe më 16.03.2021.
Rekomandimet e dala nga auditimi i MEA-s për vitin 2020 do t'iu jepen ministrive sipas përgjegjësive aktuale.
- 2 Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€, të prezantuara në nenin 19 në Raportin Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuara për faktin se 7,882,046€ pasuri, që ishin në kuadër të programit 23300, nuk ishin bartur pas ristrukturimit tek MEA. Kjo vlerë është paraqitur në pasqyrat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të këtyre çështjeve

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara

Gjetja

Rregullorja e MF - nr. 01/2017 për raportimin vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 6 kërkon që regjistrat kontabël të organizatës buxhetore të jenë të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Obligimet e papaguara të raportuara në RVF ishin prezantuar në vlerë 63,355,509€, ndërsa do të duhej të prezantoheshin në vlerë 61,750,945€, duke i mbivlerësuar për 1,604,564€. Gjatë auditimit kemi identifikuar që 8 nga 70 mostrat e testuara, faturat e shpronësimit ishin prezantuar dy herë. Për më tepër, faturat përmbanin gabime aritmetike gjatë mbledhjes së shumave, kishte gabim në bartje të shumës së faturës si dhe një faturë ishte prezantuar në raportin e obligimeve e cila ishte paguar në vitin 2020. Këto të dhëna janë bartur edhe në RVF.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme si dhe puna me staf të reduktuar për shkak të gjendjes së pandemisë kishte shkaktuar vështirësi.

Ndikimi

Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara ndikon në prezantimin jo të saktë dhe në paqartësi të informatave të cilat mund t'i çorientojnë përdoruesit e RVF.

Rekomandimi B1

Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojnë se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë dhe para prezantimit të shumave të bëhen verifikime dhe kontrolle për t'i identifikuar dhe korrigjuar gabimet para miratimit të RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu sipas nenit 6.3, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ në SIMFK nuk ishin regjistruar shtatë (7) pagesa nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë totale prej 1,854,032€.

Sipas zyrtarëve të ministrisë kjo ka ndodhur për shkak të: ndryshimeve në strukturën e ministrive gjatë vitit 2020 dhe pandemisë e cila ka ndikuar që të punohet me staf të reduktuar.

Ndikimi

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ndikon në nënvlerësimin e pasurive jo financiare dhe ofron të dhëna të pa sakta për palët e interesit apo për përdoruesit e RVF.

Rekomandimi C1

Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha pasuritë regjistrohen me kohë në SIMFK, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39, paragrafi 1 parasheh që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Ministria në dhjetë raste në vlerë të përgjithshme prej 1,421,558€ kishte tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh për pagesë. Këto obligime kanë të bëjë me kategorinë e investimeve kapitale dhe vonesat ishin prej 6 deri 124 ditë.

Deri në rishikimin e buxhetit për vitin 2020 (7 gusht 2020), MEA ka qenë pjesë e MEPTINIS dhe pas kësaj date një OB e ndarë, dhe kjo ka shkaktuar situata ku evidentimi dhe verifikimi i burimit të shpenzimit dhe faturave ka qenë i vështirë. Po ashtu, edhe mbyllja e SIMFK për periudhën e rishikimit të buxhetit, dhe puna me staf të reduktuar për shkak të gjendjes së pandemisë kishte shkaktuar vështirësi.

Ndikimi

Mos kryerja e obligimeve sipas afateve të parapara rritë rrezikun që borxhet të rriten si dhe rrit mundësinë e padive gjyqësore ndaj ministrisë. Rrjedhimisht ,rritet mundësia e pagesave shtesë si efekt i kompensimeve të vonesave dhe shpenzimeve tjera rrjedhëse.

Rekomandimi B2

Ministri i Ekonomisë dhe ai Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit 30 ditor nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë, në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari dhe pagesat me procedura përmbarimore apo gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MEA në 2020 ishin në vlerë 1,157,999€. Ato kanë të bëjnë me licencat, shfrytëzimin e ujit, lejet mjedisore komunale, participimet etj. Ne kemi testuar 5 mostra për testim substancial në vlerë të përbashkët 62,578€.

Çështja A1 - Mos funksionalizimi i Sistemit Informativ Ujor

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës neni 81.1 Sistemi Informativ Ujor përfshinë masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave si dhe çështjet e tjera me rëndësi për administrim me ujëra. Po ashtu, udhëzimi administrativ nr. 12/2013 për sistemin informativ ujor, neni 6 dokumentacioni ujor përmban: Librin e ujërave, kadastrin e ujërave, regjistrin e lejeve dhe koncesioneve ujore.

Ministria edhe pse e kishte obligim ligjor që nga mesi i vitit 2013 ta krijoj Sistemin Informativ Ujor (SIU), protokollin ujor dhe kadastrin ujor, ato ende nuk ishin realizuar. Ministria tani është në proces e sipër të vendosjes së SIU-së që nga viti 2019, mirëpo për këtë sistem ende nuk është bërë pranimi teknik dhe regjistrimi i të dhënave për librin e ujërave dhe kadastrin e ujërave. Ministria ende e mbanë në programin Excel regjistrin e lejeve ujore, i cili nuk jep ndonjë siguri për të dhënat që mbahen në të.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme për zbatimin e udhëzimit administrativ nr. 12/2013 për sistemin informativ ujor nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos funksionimi i SIU dhe mbajtja e të dhënave në Excel, rritë rrezikun e gabimeve të ndryshme dhe ndryshimin e informatave pa ruajtjen e gjurmëve të ndryshimeve që bëhen në të.

Rekomandimi A1 Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi dhe t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e tyre, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim me të gjitha informatat dhe me mundësi të qasjes së publikut.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbikëqyrje e dobët e shfrytëzuesve të ujit**Gjetja**

Neni 10 i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 02/2016 për Strukturën e Pagesave të Ujit parasheh që vendimin financiar për pagesa e nxjerrë autoriteti përgjegjës, i cili e ka lëshuar lejen ujore për shfrytëzimin e ujit, shkarkimin e ujërave dhe shfrytëzimin e inerteve. Përveç tjerash, leja ujore lëshuar nga MMPH-ja për shfrytëzuesit e ujit parasheh që për sasinë e ujit të shfrytëzuar, pala obligohet që çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në.

Ministria në vitin 2020 nuk kishte pranuar raporte lidhur me sasinë e ujit të shfrytëzuar nga 37 kompani të cilat kanë leje ujore dhe në mungesë të raporteve nuk kishte arritur të sigurojë informata lidhur me vlerën financiare të shpenzimit periodik të sasisë së ujit. Mos raportimi i sasive të ujit të shfrytëzuar, nga kompanitë që kanë leje ujore, shkakton pamundësinë e faturimit dhe matjes së efektit financiar, gjë që e dëmtojnë buxhetin e ministrisë për shkak të pamundësisë së mbledhjes së të hyrave.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ministria nuk kishte marrë masa për mungesën e raportimit për sasinë e ujit të shfrytëzuar nga këto kompani.

Ndikimi

Mos raportimi nga shfrytëzuesit e ujit, ka ndikuar në pamundësinë e faturimit të detyrimeve financiare, duke ndikuar kështu në dëmtimin e buxhetit të ministrisë dhe në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe të hyrave.

Rekomandimi B3

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e sasive të ujit nga kompanitë, që të mund të sigurojë faturimin e sasisë së ujit të shfrytëzuar në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 3,104,127€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 510 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 505 punonjës. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale.

Çështja B4 - Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Ligji 03/L-149 Për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, neni 36 parasheh që: "Orari i punës së nëpunësve civilë nuk do të tejkalojë dyzet (40) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj". Po ashtu rregullorja nr. 05/2010 për orarin e punës, neni 7 parasheh që: "Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë apo në regjistrin elektronik". Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur "Mbrojta Civile". Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit ishin caktuar të punojnë 18 dhe në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ishin caktuar të punojnë 38 ish pjesëtar të "Mbrojtjes Civile" të cilët ishin pajisur me akt emërimi.

Ne kemi vërejtur se nga 56 punonjës të tillë për 54 prej tyre ministria nuk posedon dëshmi për ta konfirmuar prezencën e tyre në vendin e punës, apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2020, ndërsa vetëm për dy (2) zyrtarë kanë arritur të ofrojnë dëshmi për të konfirmuar prezencën në punë, përdërisa ministria kishte bërë pagesat e rregullta të pagave të tyre për tërë vitin 2020. Vlera financiare për këto pagesa ishte 264,995€. Kjo gjendje ishte e njëjtë edhe në vitin e kaluar dhe e njëjta ishte raportuar në raportin tonë të auditimit për vitin 2019.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë punonjësit do të jenë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës. Për më tepër, Ministria nuk kishte ndërmarrë ende hapa konkret për krijimin e kushteve të punës për këta punonjës.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B4

Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë krijimin e kushteve të punës për të gjithë punonjësit e saj si dhe të bëjë monitorimin e rregullt të vijueshmërisë në punë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 68,724,574€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 37,908,861€. Ato kanë të bëjnë me pagesat për shpronësimet e tokave, rregullimet e lumenjëve, efikasitetin e energjisë së ndërtesave publike etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 18,785,742€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

Gjetja

Mbështetur në LMFPP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrin ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

Përmes vendimeve gjyqësore për shpronësime në vitin 2020 ishin ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari në vlerë 5,202,252€. Ministria paguan vazhdimisht shpronësime përmes vendimeve gjyqësore. Kjo, për shkak se pronarët që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit, në rastet kur ata janë të pa kënaqur me vendimin përfundimtar të shpronësimit, kanë të drejtë të ankohen në gjykatë. Për gjashtë (6) raste të testuara të këtyre pagesave në shumë 3,673,391€, Ministria ka paguar 45,032€ shpenzime shtesë për procedura të përmbartimit.

Sipas zyrtarëve, afati për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme nga data e pranimit është 30 ditë e në disa raste 15 ditë dhe pas këtij afati pala ose avokati i palës e dërgon vendimin gjyqësor në procedurë përmbartimore. Në disa raste kur pala fiton kontestin, nuk dërgon dokumentacionin e nevojshëm për pagesë në ministri, si kopjen e llogarisë bankare dhe letërnjoftimit, por e dërgon direkt te përmbartuesi. Mungesa e buxhetit për kompensimin e të gjitha kërkesave të palëve që janë përfshirë në shpronësim ka shkaktuar shpenzime shtesë në procedurat përmbartimore.

Ndikimi

Shpenzimet e taksave përmbartimore dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B5

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë që pas pranimit të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procedohet për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e bashkëfinancimeve nga ministria

Gjetja Në Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projekteve me komuna/ndërmarrje publike sipas nenit 3.3 të këtyre marrëveshjeve, "MMPH cakton një zyrtar monitorues për projekt, i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës dhe në momentin kur vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës, njofton menaxhmentin e MMPH-së".

Në (9) nëntë raste të testuara kemi vërejtur se mungon një vendim nga Ministria për emërimin e zyrtarit monitorues të këtyre projekteve të bashkëfinancuara, si rrjedhojë këtë funksion për të gjitha këto projekte e ka ushtruar koordinatori i projekteve.

Sipas koordinatorit të projekteve në ministri përkundër kërkesave të rregullta drejtuar menaxhmentit të ministrisë për caktimin e zyrtarëve monitorues siç parashihet në marrëveshjet e mirëkuptimit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Ndikimi Mungesa e zyrtarëve monitorues nga ana e Ministrisë për projektet me bashkëfinancim rrezikon mbarëvajtjen dhe zbatimin e projekteve sipas planifikimit dhe rezulton që parregullsitë apo defektet gjatë realizimit të projektit të mos raportohen në ministri. Për më tepër rritet rreziku që të bëhen pagesa të parregullta.

Rekomandimi A2 Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë që për secilën marrëveshje caktohet zyrtari monitorues i projektit, i cili do të monitoroj të gjitha fazat e projektit deri në finalizimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mos respektimi i kushteve të kontratave në ekzekutimin e pagesave**

Gjetja Sipas Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 14.4 Zyrtari Certifikues është përgjegjës që a) të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, b) të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me aktet nënligjore, ku parashihej që në secilin situacion të ndalet përqindja e avansit të paguar në fillim të kontratës deri në kompensimin e tij të plotë, si dhe mbajtja e parasë 10% si garanci për kryerjen e punimeve.

Nga mostrat e testuara, në (6) gjashtë prej tyre pagesat ishin kryer jo në përputhje me kontratat e nënshkruara:

- Kontrata "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Orllan" situacioni i IV, nuk ishte aplikuar mbajtja e parasë në vlerë 34,604€;

- Kontrata "Ndërtimi i shtratit të lumit Janjevë", situacioni i III-të nuk ishte aplikuar mbajtja e parasë në vlerë 8,094€;

- Kontrata "Rregullimi i shtratit të lumit Sazli prej hekurudhës në Ferizaj deri te lumi Sitnicë", nuk ishte aplikuar mbajtja e parasë në vlerë 17,980€;

- Kontrata "Rregullimi i shtratit të lumit Krivareka deri te ura e Domaroc", nuk ishte aplikuar mbajtja e parasë në vlerë 11,844€;

- Kontrata "Krijimi i zonave të gjelbërta dhe rregullimi i platos mbi lumin Mirush- veri", situacioni i II-të, nuk ishte aplikuar mbajtja e parasë në vlerë 12,033€; dhe

- Kontrata "Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Doberçan", situacioni i II-të llogaritje e gabuar e zbritjes së avansit prej 15% të vlerës së situacionit duke mos e ndalur shumën 7,103€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme në procesin e pagesave.

Ndikimi

Mos respektimi i kërkesave të kontratave kishte si pasojë mbi pagesën e parakohshme të situacioneve në vlerë 91,659€ me të cilat do të rritej siguria e përmbushjes së situacioneve të mbetura.

Rekomandimi A3

Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë funksionimin e kontrolleve dhe respektimin e rregulloreve gjatë ekzekutimit të pagesave, si dhe zbatimin e kushteve të kontratave dhe marrëveshjeve për bashkëfinancimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve dhe procedimit të urdhër blerjes

Gjetja

Sipas rregullës financiare nr. 01/2013/MF -shpenzimi i parave publike, hapat për procedim të pagesave janë: kërkesa për blerje; urdhërblerja; raporti i pranimi të mallit; fatura e pranuar; certifikimi i dokumentacionit për regjistrim në SIMFK; Aprovimi i pagesës nga Certifikuesi; dhe Procedimi i pagesës nëpërmes llogarisë së vetme të Thesarit.

Në 12 pagesa nga gjithsej 70 të testuara, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturave, ndërsa në 14 pagesa urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës.

Si pasojë e mos koordinimit ndërmjet menaxherit të kontratës dhe zyrtarit të prokurimit me zyrën e financave, pagesat nuk ishin proceduar sipas rregullave dhe hapave adekuat.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa zotimin e mjeteve të nevojshme, rritë rrezikun e krijimit të vonesave në realizimin e pagesave me kohë, rrjedhimisht rrit obligimet e papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Derisa, pranimi i mallrave dhe shërbimeve para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë me mos pranimin e mallrave/shërbimeve sipas nevojës dhe cilësisë së duhur.

Rekomandimi A4

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, që nga bërja e porosive deri të aktivitetet e kontrollit rreth realizimit të pagesave, në mënyrë që ato shpenzime të procedohen sipas rregullave dhe hapave të paracaktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos funksionalizimi i Sistemit Elektronik të Shpronësimit

Gjetja

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/78 të datës 09.03.2016 obligohen të gjitha institucionet Shtetërore dhe Publike, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për përdorimin e Sistemit Elektronik të Shpronësimit (SESH) të krijuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke futur të dhënat e punës së tyre gjatë procesit të shpronësimit, vlerësimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, institucionet tjera shtetërore dhe publike të cilat janë të përfshira në procesin e shpronësimit, të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205.

Për ta menaxhuar më lehtë çështjen e shpronësimeve, MMPH-ja është në proces e sipër të vendosjes së (SESH) që nga viti 2013, mirëpo ky sistem ende nuk është funksionalizuar dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vazhdon të kryhet në mënyrë manuale në programin Excel.

Data-baza ku ruhen të dhënat e pagesave të ekzekutuara ndër vite për shpronësimet mbahet në formatin Excel, gjë që paraqet rrezik të lartë që shënime të humbasin ndryshohen apo të manipulohen, duke mos lënë gjurmë.

Elementet e informatave të data-bazës ishin të mangëta, sipas rasteve, nuk shënohet numri i parcelës i plotë siç është i përshkruar në fletë poseduese, nuk shënohet numri personal i pronarit/përfituesit, nuk shënohet projekti me të cilin kanë të bëjnë ato shpronësime.

Po ashtu, në (9) nëntë raste të testuara të pagesave për shpronësime, në katër raste në Sistemin e Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë nuk ishte regjistruar vërejtja se këto prona janë në shpronësim, ngase mungonin të dhënat e regjistruara nga ana e Zyrës Kadastrale Komunale përkatëse për pronat gjegjëse. Vetëm në një (1) rast nga këto pagesa prona ishte regjistruar në kadastër në pronësi të Republikës së Kosovës.

Sipas zyrtarëve përgjegjës të Ministrisë (departamenti i shpronësimit) janë duke marrë veprime në vazhdimësi për zbatimin e këtij vendimi, por për shkak se kemi të bëjmë me një softuer i cili përfshinë një fushë të gjerë dhe të komplikuar kjo kërkon sigurimin e kapaciteteve njerëzore, profesionale e teknike dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Ndikimi

Mos funksionalizimi i SESH-it dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vetëm në Excel, si dhe mungesa e një procedure për të funksionalizuar plotësisht këtë proces, rritë rrezikun e gabimeve dhe cenon sigurinë e të dhënave.

Rekomandimi A5

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim nga të gjitha institucionet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVF e pasurive kapitale është 313,205,470€, pasurive jokapitale është 820,185€ si dhe e stoqeve 90,501€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 225,124,735€.

Çështja A6 - Pasuria që nuk i është nënshtruar normave të zhvlerësimit

Gjetja Neni 22 pika 3, i rregullores MF-Nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore thekson se: 'Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit'.

Ministria kishte pranuar pajisjen sipas kontratës "Furnizim me pajisje SEM për Laboratorin e Gjeologjisë" me datë 18 tetor 2017. Vlera neto në libra me 31 dhjetor 2020 është e pa ndryshuar nga data e blerjes, si rezultat i mos aplikimit të normave të përgjithshme të zhvlerësimit siç parashihet në rregullore. Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e vlerës së pasurive në regjistrat e pasurisë dhe pasqyra financiare në shumë prej 263,354€.

Kjo sipas zyrtarëve të Ministrisë ka ndodhë si pasojë e një gabimi teknik gjatë regjistrimit të pasurisë dhe për këtë shkak viti i blerjes nuk përkon me vitin e regjistrimit në SIMFK.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave të plota për menaxhimin e pasurisë dhe shpalosje jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.

Rekomandimi A6 Ministri i Ekonomisë të sigurojë mbikëqyrje adekuate gjatë regjistrimeve të pasurive dhe gjatë raportimeve periodike në mënyrë që të mundësohet identifikimi i gabimeve para se të përgatiten pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mos evidentimi i pasurive të cilat menaxhohen nga Ministria

Gjetja Sipas Kornizës së Përgjithshme Konceptuale të Raportimit Financiar për Sektorin Publik, asetet e sektorit publik që shprehin potencialin e shërbimeve si rekreacione, trashëgimi etj. të cilat mbahen nga Qeveria ose entitet e sektorit publik dhe të cilat përdoren për të ofruar shërbime palëve të treta, mund të jenë për konsum kolektiv ose individual në zona ku nuk ka konkurrencë në treg ose konkurrencë të kufizuar në treg. Entiteti i sektorit publik mundet, por nuk kërkohet që të aplikoj kërkesat për matjen e këtyre pasurive, por duhet t'i shpalosin me të gjitha detajet aktuale dhe specifike të tyre.

MEA ka nën menaxhimin dhe kontrollin e vet Parkun Kombëtar "Sharri", Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", "Shpellën e Gadimës" dhe Ujëvarat e Mirushës. Ministria krijon të hyra nga shitja e biletave të vizitoreve të shpellës së Gadimës dhe nga shfrytëzimi i resurseve natyrore të parqeve kombëtare. Gjatë vitit 2020 ministria nga administrimi i këtyre pasurive kishte krijuar të hyra në vlerë 134,703€. Megjithatë, ministria këto pasuri nuk i ka të regjistruara në regjistrin e SIMFK-së dhe nuk kishte shpalosur informacionin në pasqyra financiare të vitit 2020 lidhur me to.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos definimit të të drejtave pronësore në mes të agjencive dhe ministrive si dhe pa mundësisë së vendosjes së ndonjë vlere si rrjedhojë e mungesës së ndonjë vlerësimi paraprak.

Ndikimi

Mungesa e regjistrimit të pasurive dhe mungesa e shpalosjes së informacionit të nevojshëm lidhur me to ndikon në nënvlerësimin e vlerës së pasurive që ministria dhe qeveria i ka në pronësi, dhe rrjedhimisht ndikon në saktësinë e RVF të ministrisë.

Rekomandimi A7

Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurohen që pasuritë të cilat i kanë në posedim dhe prej tyre krijojnë të hyra të shpalosen me të gjitha detajet aktuale dhe specifikat e tyre në RVF në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të kenë informacion të plotë lidhur me përbërjen e pasurive të Ministrive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Ministria në RVF-të vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,638,517€. Kjo vlerë përbëhet nga obligimet e kompanive të cilat e shfrytëzojnë ujin, nuk i kanë kryer obligimet e tyre financiare.

Çështja B6 - Mos marrja e veprimeve ndaj shfrytëzuesëve të ujit pa leje ujore

Gjetja

Ligji nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës neni 97, parasheh në hollësi veprimet dhe kompetencat që duhet të ndërmarrë Inspektorit i ujërave në rastet kur identifikon kryerje të aktiviteteve pa leje ujore apo në kundërshtim me lejen. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat dhe me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre.

Nga regjistri i pranuar prej ministrisë për shfrytëzuesit e ujit kemi vërejtur se, janë mbi 87 shfrytëzues të ujit, të cilëve ju ka skaduar leja ujore dhe sipas ministrisë nuk iu ka vazhduar më për shkak të mos shlyerjes së borxheve të akumuluar. Edhe pse, sipas ministrisë këta shfrytëzues vazhdojnë të shfrytëzojnë ujin pa leje ujore dhe pa e kryer obligimin financiar. Inspektorati i ujërave as gjatë vitit 2020 nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre në bazë të kompetencave që i takojnë. Inspektorati gjatë vitit 2021 ka realizuar takime me Oden Ekonomike të Kosovës dhe Shoqatën e Ambalazhuesve të ujit dhe pijeve alkoolike dhe jo alkoolike dhe janë duke bërë përpjekje që të rregullohet gjendja.

Kjo ka ndodhur për shkak se inspektorati, duke punuar me staf të reduktuar, ishte fokusuar vetëm në shqyrtimin e ankesave.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve të nevojshme për parandalimin dhe rregullimin e dukurive të tilla ndikon në shfrytëzimin e pa kontrolluar të ujit, në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe të hyrave, si dhe në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi B6

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos zbatimi i marrëveshjes për programimin e shlyerjes së borxhit**Gjetja**

Ministri i MMPH-së në vitin 2018, kishte lidhë marrëveshje me kompanitë publike rajonale të ujit me qëllim të programimit dhe shlyerjes së borxheve të akumuluarra për shfrytëzimin e ujit gjatë viteve 2007-2017, duke programuar shlyerjen e tyre, në 5 këste, për 5 vite. Shlyerja e borxhit sipas marrëveshjeve fillon nga viti 2018 dhe përfundon në vitin 2022. Neni 5 i marrëveshjeve parasheh se në rast të mos zbatimit të marrëveshjes me MMPH-në për kthimin e borxhit, kompanive publike të ujit, në mënyrë automatike do të ju pushoj vlefshmëria e lejes ujore dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit”.

Kemi testuar 5 mostra ku vlera e borxhit për shlyerje sipas marrëveshjeve ishte 216,373€ dhe kemi vërejtur se 3 kompani rajonale të ujit (KRU) nuk kishin shlyer obligimin financiar (këstin) dhe njëra kishte kryer pjesërisht obligimin financiar për vitin 2020 sipas marrëveshjes. Vlera e kësteve të pa paguara ishte 74,850€. Ministria përmes e-mail-it kishte kërkuar kryerjen e obligimeve mirëpo nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim siç parashihej me marrëveshje që: në rast të mos përmbushjes së obligimeve, kompanive publike të ujit në mënyrë automatike do të ju pushoj vlefshmëria e lejes ujore dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të dobët të zbatimit të marrëveshjeve me kompanitë rajonale të ujit.

Ndikimi

Monitorimi i dobët i marrëveshjeve për shlyerjen e borxheve ndikon në dëmtimin e buxhetit të ministrisë dhe në krijimin e praktikave jo të mira në të ardhmen për inkasimin e të hyrave të ministrisë.

Rekomandimi B7

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj KRU-ve, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerjen e borxhit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 63,355,508€. Këto detyrime janë bartur nga vitet paraprake për t'u paguar në vitin 2021. Këto obligime kryesisht janë ndaj ish pronarëve të parcelave të shpronësuara për ndërtimin e rrugëve.

Çështja B8 - Mos-pagesa e obligimeve financiare të shpronësimit

Gjetja Neni 39 i Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se “Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”

Kemi vërejtur se 53,612,748€, ishte vlera e aplikimeve (kërkesave) të pronarëve për kompensim të shpronësimit në vitin 2020, të cilat nuk kanë arritur të procedohen për pagesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të ndara për shpronësime.

Ndikimi Mos kryerja me kohë e obligimeve financiare për shpronësime, ndikon që ministria të përballët me padi nga ish-pronarët e pronave të shpronësuara, ku për shkak të taksave gjyqësore, ndëshkimeve dhe interesave, këto obligime vazhdojnë të rriten edhe më shumë.

Rekomandimi B8 Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve në mënyrë që t'i shmangin ndëshkimet dhe kostot shtesë për shkak të vonesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me 4 auditorë një ndër ta-Drejtori i NJAB. NJAB ka përgatitur Planin Strategjik (2020-2022) dhe planin vjetor të cilët ishin miratuar nga Komiteti i Auditimit. NJAB, kishte raportuar në baza të rregullta edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Çështja B9 - Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm

Gjetja Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Ne kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB dhe kemi vërejtur një zbatim të ulët të rekomandimeve. Nga 35 rekomandime të dhëna, 15 ishin zbatuar, 7 ishin në proces dhe 13 rekomandime ishin të pa zbatuara.

Kjo kishte ndodhur pasi që menaxhmenti nuk i kishte dhënë rëndësinë e duhur rekomandimeve të NJAB-së.

Ndikimi Mungesa e gatishmërisë për të zbatuar plotësisht rekomandimet e NJAB-së ndikon në mos përmirësimin e proceseve të cilat më pas ndikojnë në mos arritjen e objektivave të Ministrisë.

Rekomandimi B9 Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitet përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikua një çështje që iu komunikua menaxhmentit dhe u zgjidh në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të më tutjeshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimit të ndërmarrë dhe rezultatit.

Çështja jo-materiale të cilën e kemi identifikuar dhe ishte përmirësuar gjatë kohës së auditimit:

Çështja 1 **Parregullsi në ekzekutimin e pagesave për projektet me bashkëfinancim**

Gjetja

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe KRU "Hidromorava" kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Dobërçan", nr. protokoli 4818/19 e datës 30.07.2019. Hidromorava ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik me datë 22.10.2019. Sipas nenit 3 pika 3.2 të kontratës çmimi i përmendur në nenin 3.1 duhet të jetë e vetmja pagesë që Autortiteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës.

Situacionin e dytë dhe të tretë operatori ekonomik e ka faturuar përtej çmimit të kontraktuar, duke shtuar vlerën e TVSH-së 18% si rezultat i keq interpretimit të vendimit shpjegues të ATK-së me nr. 03/2019 Detyrimi për të paguar TVSH-në për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit - Aplikimi i ngarkesës së kundërt'. Vlera e pagesave mbi çmimin e kontraktuar për dy situacionet ishte 40,584€.

Veprimi i kërkuar

Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme që mjetet e paguara më tepër të kthehen në buxhetin e ministrisë si dhe të forcojnë kontrollet gjatë ekzekutimit të pagesave për tu siguruar se nuk do të përsëriten rastet e tilla.

Rezultati

Ministria përmes autoritetit kontraktues të këtij projekti (në këtë rast KRU Hidromorava) ka bërë kthimin e mjeteve nga operatori ekonomik të paguara më tepër, të cilat janë transferuar në buxhetin e Kosovës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	88,215,312	269,482,155.96	209,948,797.00	25,698,492.61	22,447,005.79
Grante Qeveritare - Buxheti	82,015,312	194,742,438.50	167,149,191.07	21,113,353.30	16,849,411.58
Financimi përmes huamarrjes	6,200,000	11,498,247.50	6,103,137.22	3,638,047.77	5,597,594.21
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0.00	23,032,000.00	84,843.18	0.00	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	39,456,665.27	36,496,366.02	947,091.54	0.00
Donacionet vendore	0.00	3.00	0.00	0.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	752,801.69	115,259.51	0.00	0.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 131,464,679€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2020 në kodin organizativ të kësaj ministrie ishin të përfshira Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në vitin 2020, ministria ka shpenzuar 78% të buxhetit final ose 209,950,303€.

Buxheti final ishte rritur krahas buxhetit fillestar për të gjitha kategoritë me rishikim të buxhetit për shkak të ristrukturimit të kësaj ministrie dhe vendimeve të ndryshme nga qeveria për ndarje, kursime dhe rregullime buxhetore si pasojë e situatës së krijuar me pandeminë COVID 19. Gjatë vitit 2020 janë shpenzuar 60,838,562€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për shpenzime për Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike nga projekti 00098, ndërsa për Pako Fiskale Emergjente nga projekti 00099 janë shpenzuar 81,404,131€ nga kategoritë subvencione dhe transfere dhe mallra dhe shërbime.

Krahasimi i shpenzimeve në mes të viteve është i pa përfillshëm për shkak të ndryshimeve strukturore që kanë ndodhur gjatë vitit 2020.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	88,215,312	269,482,155.96	209,948,797.00	25,698,492.61	22,447,005.79
Pagat dhe mëditjet	5,079,622	3,104,127.23	3,098,435.66	1,277,878.61	1,293,194.58
Mallrat dhe shërbimet	7,828,407	14,068,918.52	11,171,517.33	2,053,420.89	3,789,853.34
Komunalitë	340,175	80,061.56	64,552.67	12,960.69	12,850.73
Subvencionet dhe transferet	37,438,870	183,504,474.82	157,705,429.84	14,731,511.55	8,984,721.18
Investimet Kapitale	37,528,238	68,724,573.83	37,908,861.50	7,622,720.87	8,366,385.96


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë: Kategorinë paga dhe mëditje dhe investime kapitale ishin zvogëluar për shkak të situatës së krijuar me Covid-19 duke pamundësuar realizimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit si dhe mos realizimi i projekteve kapitale.

Ndërsa për kategoritë subvencione dhe transfere, mallra dhe shërbime dhe komunalitë buxheti final ishte rritur për shkak të Pakove Fiskale Emergjente dhe Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Në totalin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2020, ishin subvencionet dhe transferet 75%, investimet kapitale 18%, pagat dhe mëditjet 1.47% , si dhe mallra dhe shërbimet bashkë me komunalitë ishin 5.35% të shpenzimeve totale.

Buxheti final për të hyrat për vitin 2020 ishte 807,895€, ndërsa realizimi i tyre ishte 1,157,999€. Këto të hyra kanë të bëjnë me licencat, shfrytëzimin e ujit, leje mjedisore komunale dhe participimet.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	971,013.00	807,895.00	1,157,999.25	1,318.24	300.00
Të hyrat jo tatimore	971,013.00	807,895.00	1,157,999.25	1,300.00	300.00
Të hyrat tjera	0.00	0.00		18.24	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për RVF-të e vitit 2019 të tri ministrive që u bashkuan në MEA (MZHE, MMPH dhe MIN) ka rezultuar në 27 (6+14+7) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 11 rekomandime janë zbatuar, 1 ishte në proces, 9 nuk janë adresuar ende dhe 6 rekomandime nuk janë të aplikueshme më, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Subvencionet & Transfere - fonde të tjera	Menaxhmenti i ministrisë të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit për secilën kategori bazuar në nevojat reale të ministrisë dhe të bëhen pagesat nga kodi adekuat.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë auditimit të vitit 2020.	I zbatuar
2.	Subvencionet & Transfere - fonde të tjera	MMPH-Ministri duhet të siguroj që më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, të përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe t'ia dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.	Nga Ministria për vitin 2020 nuk ishin subvencionuar OJQ-të.	I zbatuar

3.	Subvencionet & Transfere - fonde të tjera	MIN-Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat të projektit Start-up, me qëllim të vlerësimit të objektivave të ministrisë. Kjo situatë kërkon një vlerësim rigoroz në këtë vit, të përcaktohen qartë përgjegjësitë në vendimmarrje, në mënyrë që të përmbillet procesi i krijimit të bizneseve nga përfituesit, apo në të kundërtën të kthimit të mjeteve	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar pasi që kemi identifikuar që dy përfitues të start-up-ve nuk kishin bërë hapjen e bizneseve.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Subvencionet & Transfere - fonde të tjera	MIN-Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Startup-et, për sigurimin e dëshmimeve të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Të hyrat	MMPH-Ministri duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e ujit nga kompanitë, të sigurojë vlerën financiare të sasisë së ujit të shfrytëzuar dhe të bëjë faturimin në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.	Edhe këtë vit gjendje është e njëjtë.	Nuk është adresuar
6.	Pagat dhe mëditjet	MMPH-Ministri duhet të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i vijueshmërisë në punë për të gjithë punonjësit e ministrisë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.	Përderisa i njëjti rekomandim është edhe tek ministria e ekonomisë njëri do të bëhet i mbyllur ndërsa tjetri i pa zbatuar.	Nuk është i aplikueshëm më
7.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mosvijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të ndjeshmërisë së këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Ministria kishte vazhduar t'i paguaj ish pjesëtar të Mbrojtjes Civile edhe pse të njëjtit nuk kanë vijuar punën as gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	MMPH-Ministri duhet të siguroj se angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta bëhen duke aplikuar procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit të parapara me ligj dhe kohëzgjatja e tyre të jetë brenda afatit 6 mujor.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë vitit 2020.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	MMPH-Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalimi i kontratës arrin shkallën 30% kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë vitit 2020.	I zbatuar

10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	MIN-Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.	Gjatë vitit 2020 nuk kishte shpenzime për vendime gjyqësore nga departamenti i MIN.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	MMPH-Ministri duhet të siguroj se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari.	Edhe këtë vite kemi hasur në vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk është adresuar
12.	Investimet kapitale	Ministri duhet të ndërmarrë masat e duhura që në koordinim me Komunën Gjakovës të zgjidhë problemin që e ka shkaktuar vonesën e realizimit të projektit dhe të sigurojë realizimin e plotë të punëve në afat sa më optimal.	Projekti kishte përfunduar.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	MMPH-Ministri duhet të sigurojë që pas pranimit të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procesohet për pagesë.	Edhe këtë vit janë realizuar pagesa përmes vendimeve gjyqësore.	Nuk është adresuar
14.	Investimet kapitale	MMPH-Ministri duhet të siguroj se për vitet vijuese shpenzimet e shpronësimit të regjistrohen sipas planit kontabël në mënyrë që ato të klasifikohen saktë.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë vitit 2020.	I zbatuar
15.	Çështjet e përbashkëta	MIN-Ministri duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode dhe kategori ekonomike adekuate, siç parashihet me planin kontabël të SIMFK me qëllim të prezantimit dhe shpalesjes së informatave të drejta për shfrytëzuesin e raporteve financiare.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë vitit 2020.	I zbatuar
16.	Pasuritë	MIN- Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet kapitale të regjistrohen në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim të barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia. Po ashtu, të siguroj se stoqet janë regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç kërkohet me Rregullore.	Disa nga investimet në vijim ishin bartur tek komunitat.	Pjesërisht i zbatuar
17.	Pasuritë	MIN-Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare të organizatave buxhetore. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në raportimet vjetore.	Është përfunduar procesi i inventarizimit para përpilimit të PFV.	Nuk është i aplikueshëm më


18.	Pasuritë	Ministri duhet që të siguroj funksionimin sistematik të kontrollit lidhur me azhurnimin në kohë reale të regjistrit të pasurisë kapitale.	Nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të tillë gjatë vitit 2020.	I zbatuar
19.	Pasuritë	MMPH-Ministri duhet të siguroj që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF dhe të gjitha pasuritë që financohen për organizatat tjera pas plotësimit të kushteve të barten tek përfituesit.	Vlera e pasurive ishte nënvlerësuar.	Nuk është i aplikueshëm më
20.	Pasuritë	MMPH-Ministri duhet të siguroj që çdo fund vit të formohen komisionet e parapara me rregullore për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në mënyrë që të shmangen devijimet në raportimin e vlerës së pasurive në Raport Vjetor Financiar.	Komisioni për inventarizim ishte themeluar për MEA-n. Pasi që ky rekomandim ka qenë edhe në raportin e MMPH edhe tek MIN njëri do të jetë i mbyllur e tjetri i zbatuar.	I zbatuar
21.	Llogaritë e arkëtueshme	MMPH-Ministri të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet e keqpërdorimit nga kompanitë që operojnë në këtë fushë, të marrë masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.	Ministria nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë për shfrytëzuesit e lejeve ujore me afat të skaduar.	Nuk është adresuar
22.	Llogaritë e arkëtueshme	MMPH-Ministri duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj kompanive ujore, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerje të borxhit	Gjatë auditimit kemi identifikuar që nuk ishin kryer obligimet nga KRU.	Nuk është adresuar
23.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç parashihet me neni 39 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.	Edhe këtë vitë kemi hasur në vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk është i aplikueshëm më
24.	Obligimet e papaguara	MMPH-Ministri të siguroj se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë në mënyrë që shënimet në RVF të jenë të sakta.	Ministria kishte mbivlerësuar obligimet e papaguara.	Nuk është adresuar
25.	Obligimet e papaguara	MMPH-Ministri i MMPH-së në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve të cilat janë duke u rritur nga viti në vit.	Departamenti i shpronësimit nuk kishte buxhet të mjaftueshëm për ti kryer obligimet e saj.	Nuk është adresuar

26.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.	Nuk ishte arritur zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga NJAB.	Nuk është adresuar
27.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të ndërmarr veprimet adekuate për të siguruar burimet e mjaftueshme njerëzore për kompletimin e NJAB-së si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore dhe strategjike të NJAB.	Pasi që është bërë fuzionimi i ministrive ka numër të mjaftueshëm të auditorëve.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e sasive të ujit nga kompanitë, që të mund të sigurojë faturimin e sasisë së ujit të shfrytëzuar në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.
2.	Të hyrat	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi dhe t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e tyre, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim me të gjitha informatat dhe me mundësi të qasjes së publikut.
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë krijimin e kushteve të punës për të gjithë punonjësit e saj si dhe të bëjë monitorimin e rregullt të vijueshmërisë në punë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.
4.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim nga të gjitha institucionet.
5.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë që për secilën marrëveshje caktohet zyrtari monitorues i projektit, i cili do të monitoroj të gjitha fazat e projektit deri në finalizimin e tyre.
6.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë funksionimin e kontrolleve dhe respektimin e rregulloreve gjatë ekzekutimit të pagesave, si dhe zbatimin e kushteve të kontratave dhe marrëveshjeve për bashkëfinancimin e projekteve.
7.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, që nga bërja e porosive deri të aktivitetet e kontrollit rreth realizimit të pagesave, në mënyrë që ato shpenzime të procedohen sipas rregullave dhe hapave të paracaktuar.
8.	Investimet kapitale	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit 30 ditor nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë, në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari dhe pagesat me procedura përmbarimore apo gjyqësore.
9.	Investimet kapitale	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojë që pas pranimi të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procedohet për pagesë.

10.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurojnë se të gjitha pasuritë regjistrohen me kohë në SIMFK, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF.
11.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë të sigurojë mbikëqyrje adekuate gjatë regjistrimeve të pasurive dhe gjatë raportimeve periodike në mënyrë që të mundësohet identifikimi i gabimeve para se të përgatiten pasqyrat financiare vjetore.
12.	Pasuritë	Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të sigurohen që pasuritë të cilat i kanë në posedim dhe prej tyre krijojnë të hyra të shpalosen me të gjitha detajet aktuale dhe specifikat e tyre në RVF në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të kenë informacion të plotë lidhur me përbërjen e pasurive të Ministrive.
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj KRU-ve, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerjen e borxhit.
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.
15.	Obligimet e papaguara	Ministri i Ekonomisë dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të sigurojnë se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë dhe para prezantimit të shumave të bëhen verifikime dhe kontrolle për t'i identifikuar dhe korrigjuar gabimet para miratimit të RVF.
16.	Obligimet e papaguara	Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve në mënyrë që t'i shmangin ndëshkimet dhe kostot shtesë për shkak të vonesave.
17.	Auditimi i Brendshëm	Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm

Enver Boqolli, Udhëheqës i Auditimit



Liridona Berisha, Udhëheqëse e ekipit



Besim Lezi, Anëtar i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
BËTËSI: JETË DREKTOR BËTË: NIKOLLA P. VISIPIRI DREKTOR I ZYRËS			
21.07.2021			
Klasifikim Org. Jakt. Org. Ushq.	Shif. Klasif. Klasif. KOD Klasif. Codi	Nr. Prot. Dk. Prot. Prot. No.	Nr. Fletëve Dk. Stranica No. Pages
03	47	1258	1

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA - GOVERNMENT MINISTERIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njësia Org. Org. Jakt. Org. Ushq. Dk. Stranica No. Pages	Nr. Prot. Dk. Prot. Prot. No. Dk. Prot. Prot. No.	Nr. Fletëve Dk. Stranica No. Pages	Data Datum Date
01	1893		21.07.21
PRISHTINE A			NO. 1



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Artane Rizvanolli..... *A. Rizvanolli*

Ministre e Ekonomisë,

Data: 21. korrik 2021, Prishtinë,

Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE			
26.07.2021			
03	44	13/14	1



REPUBLIKA E KOSOVËS MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Proshkrimi: Organi/Entiteti: Nr. i Fajësive: Nr. i Shtetit: Nr. i Pajësive:	01-M.	Ti i Përk: Bashkëpun. Prost. No.:	2876/21
	-06-	DATA: Datimi:	26.07.21
PRISHTINË / A			No.1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Data: 23/07/2021
Prishtinë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Liburn Aliu

Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ “Rregullimi i shtratit të Lumbardhit në Deçan, vlera e situacionit 542,997 €; Renovimi i 30 ndërtesave (lot 1 dhe Lot 2), vlera e situacionit 310,659 €; “ndërtimi i sistemit të ujësjellsit në fshatin Orllan-Podujevë”, vlera e situacionit 294,134 €; “Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsit respektivisht me kyçjet individuale të amvisrive dhe atyre komerciale në fshatrat e komunës së Vushtrrisë në rrjetin e ujësjellsit të rreth 9,000 amvisrive dhe/ose objekteve komerciale”, vlera e pagesës 281,773 €; “Rregullimi I shtratit të lumit Ibër në Mitrovicë”, vlera e situacionit 160,663 €; Rregullimi I Shtratit të Lumit IBËR në Mitrovicë”, vlera e situacionit 135,723 €; Ndërtimi i kanalizimit të ujrave të zeza në fshatin Novosellë, Radac, Jabllanicë e madhe, Dubovc dhe Ozdirim, vlera e situacionit 128,081 €.
- ⁶ Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsit - Vushtrri; Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Doberqan; Krijimi i hapsirave gjelbruese dhe rekreative për fëmijë në Mitrovicë; Rregullimi i shtratit të Lumbardhit në Deçan; Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit Morava e Binçes; Rregullimi i shtratit të lumit Ibër - Mitrovicë; Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica - Mitrovicë; Rregullimi i shtratit të proit në Rubovc; Krijimi i zonave të gjelbërta në Gjilan.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.